



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 33 Datë 04.05.2010

PER
Alokim fondi per blerje stola dekorative

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "Për alokim fondi per blerje stola dekorative, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 10190 dt. 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010», Udhëzimin nr.1 dt.19.04.2010 M.F «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010», V.K.B nr. 20 dt. 25.03.2010 « Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr. 9643 dt. 20.11.2006 «Për prokurim publik », i ndryshuar, si dhe V.K.M. nr. 1 dt. 10.01.2007 «Për rregullat e prokurimit publik », dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje fondin për blerjen e stolave dekorative (gize).
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezerve i te ardhurave te Bashkisë 2010 me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet Bashkia	00	04980	05	Art 6090000	-	400,000 leke
Shtohet NSHP	00	06260	05	Art 2310000	+	400,000 leke

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

GJERGJI PENDAVINJI